ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-23-6058-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Qendra mobile për kontrollim teknik të automejteve në rrugë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" Profitech " SH.P.K.**
NUI	**810081646**
Adresa	**Rr. Ilaz Kodra Nr. 5**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044784278**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Burim Vrajolli**
Adresa elektronike	**profitech.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**08.09.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Qendra mobile për kontrollim teknik të automejteve në rrugë.

Njoftim për Kontratë; Data e publikuar: 13.06.2023

Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues; Data e publikuar: 17.08.2023

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 28.07.2023 në 14:00 orë

Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datë 22.08.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pran AK "MINISTRIA E INFRASTRUKTURES" .

Të bashkangjitur mund të gjeni "Kërkesën për Rishqyrtim" si dhe "Vendimin" - "Përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim" nga AK "MINISTRIA E INFRASTRUKTURES" të publikuar me datë: 29.08.2023

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

Neni 1 - Qëllimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 26 - Grup i Operatorëve Ekonomik i Rregullores Nr.001_2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në "Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues" si dhe "Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar" të datës: 17.08.2023, vendimi i marr nga Komisioni Vlerësues është i pa bazuar;

Në "Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar" të datës: 17.08.2023, tenderi ynë është refuzuar me arsyetimet si më poshtë:

Arsyetimi Nr. 1:

Operatorit Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose

profesionale ne piken 4. Projekti i detajuar i cili përmban te gjitha pajisjet, se si duket nje qendër mobile dhe si do te funksionoj. Deshmija 4. - OE duhet te prezantoj nje projekt detaj se si do te funksionoj kjo qender mobile per realizimin e qellimit te ketij projekti.

Operatori eknomike nuk ka prezantuar Projektin e detajuar sipas kërkesës te FDT-se.

Ne në dosje të tenderit e kemi prezantuar ofertën teknike në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet e ofruara një nga një të qendrës mobile, si dhe katalogjet për secilin pozicion veç e veç dhe katalogun në të cilën shihet se si duket dhe si funksionon qendra mobile, që do të thotë se është ofruar çdo detaj në lidhje me qendrën mobile të ofruar.

Si dëshmi të bashkangjitur mund të gjeni dokumentet te cilat janë pjesë e tenderit:

Katalogu (emërtimi i dokumentit):

7. General Catalogue - MTL_Mobile_Test_Line_ENG_R3.pdf

Oferta Teknike (emërtimi i dokumentit):

8. Technical offer - MTL - Mobile trucks, buses, heavy-duty vehicles & cars inspection line.pdf

Katalogjet për secilin pozicion (emërtimi i dosjeve)

13. Katalogjet 1.rar

14. Katalogjet 2.rar

Arysetimi Nr. 2:

Nuk keni ofruar deklaratën per Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik sipas Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik paragrafi 26.1 ne piken c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partenrin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; ju si grupe i operatoreve ekonomike keni paraqitur Burim Vrajollin i cili nuk është partner ne grupin e operatorit ekonomike.

Sa për sqarimin tuaj Burim Vrajolli është Drejtor i Autorizuar dhe inxhinier i makinerisë në kompaninë "Profitech sh.p.k.", i certifikuar nga Maha dhe Beissbarth për disa pajisje kalibruese që i takojnë veprimtarisë të ketij projekti.

Burm Vrajolli është Drejtor i Autorizuar i Kompanisë Profitech sh.p.k. në këtë rast liderit të Grupit të Operatoreve Ekonomik dhe në pikën C. të Deklaratës për Themelimin e Grupit të Operatorëve është deklaruar shume qarte se:

We below undersigned authorise Mr. Burim Vrajolli as the lead partner to act on behalf of the group.

Përkthim:

Ne poshtë të nënshkruarit autorizojmë z. Burim Vrajolli si partner lider për të vepruar në emër të grupit.

Në faqen numër dy të Deklaratës për Themelimin e Grupit të Operatorëve shihet shumë qartë nënshkrimi dhe vula e të dy partnerëve të Grupit.

Si dëshmi mund të gjeni të bashkangjitur dokumentin i cili është pjesë e tenderit:

Deklarata për Themelimin e Grupit të Operatoreve (emërtimi i dokumentit):

5. P&V Establishing a Group of economic oper.pdf

Vlen të ceket po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për **38,890.42 Euro** më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, ku AK në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

sipas Neni 1 Qëllimi, ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera.

dhe Neni 6 **Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,** paragrafi **1**, ku**:**

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

Më datë 22.08.2023 kemi bërë kërkesë për qasje në dosje të tenderit tek AK dhe na është mundësuar qasje po të njëjtën datë 22.08.2023.

Kemi venë re se Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar per kontrate "TRAFFIKS VA SH.P.K. Autoinstrument dooel Skopje" është i papërgjegjshëm dhe nuk është në përputhshmëri me kerkesat në FTD të dosjes së tenderit në pikat si më poshtë:

Pika 1:

Sipas Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik Neni 26, "Grupi i Operatorëve Ekonomik", OE te rekomanudar per kontrate i mungon Deklarata per themelimin e Grupit te Operatoreve Ekonomik gjegjegjesisht pika a, b, c te paragrafit 26.1.

Në bazë të UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, OE të rekomanduar për kontratë do te duhej ti refuzohej tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Pika 2:

Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 eshte kerkuar:

2. Lista e kontratave te realizuara dhe perfunduara për periudhën e shkuar tre vjeçare (2020, 2021 dhe 2022) jo më pak se 700,000.00 €

Deshmia 2. Kopje te kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar të pajisjeve, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve te realizuara per periudhën e shkuar tre vjeçare, te shoqruara me referenca dhe proqesverbale te pranimit te pajisjeve

Ndersa Grupit te OE-ve të rekomanduar për kontratë i mungojnë referencat sipas kërkesës

në FTD të dosjes së tenderit.

Kontratat të cilat janë paraqitur të gjitha jane si nenkontratkor dhe e tyre shumica janë për sinjalizim rrugor që nuk kane të bëjnë me furnizim dhe trajnim të projektit në fjalë.

Pika 3:

Bazuar ne Informatat mbi Biznesin te OE TRAFFIKS VA SH.P.K, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka veprimtarinë per tenderin në fjalë.

Pika 4:

Në Specifikacionet teknike të detyrueshme, neni 3.1, pika a) është kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

aDeklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Grupit te OE te rekomanduar për kontrate i mungon Deklarata e Përputhshmërisë.

Pika 5:

Në Sqarime në pyetjet e parashtruara nga Operatori Ekonomik te dërguar nga AK ne piken 8 nën a) është kërkuar:

8. Me rastin e përzgjedhjes së numruesit të grimcave pn jemi përcaktuar për teknologjinë CPC. Pajisja mund të jetë e cilit do prodhues i cili i plotëson kushtet si në vijim:

Certifikatën e konformitetit si dokument i cili dëshmon se PN është egzaminuar/ miratuar në përputhje me kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara në dokumetet e aplikuara në BE. E lëshuar nga ndonjë prej vendeve të BE – së (psh. Holandë, Zvicër, Gjermani) të ofrohet bashkë me materialin tenderues.

Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë Certifikatë te Konformitetit si dëshmi.

Neve si OE na është bërë e padrejtë në ketë rast përderisa ne kemi aplikuar ne konzoricum ne tender me një prodhues te madh Italian siç është VAMAG dhe jemi plotësisht te përgjegjshëm, andaj kërkojmë nga ana juaj që lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në ankesën tonë kërkojmë nga ana juaj të merrni këtë vendim:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "Profitech sh.p.k."

ANULOHET Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar me datë: 17.08.2023, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të shpallet fitues OE "Profitech sh.p.k."

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e demeve te shkaktuara eshte 6,000.00 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*